



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 367 / Prot.
13

Gramsh, më 11.03. 2024

V E N D I M

Nr. 23, date 29/02/ 2024

PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.67, DATË 29.09.2023 TË KËSHILLIT
BASHKIAK GRAMSH "PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E
PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK PËR
NDËRTIM DHE OPERIM TË HEC "GRABOVA 1", NGA SHOQËRIA "GRABOVA
HYDROPOWER"shpk".**

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 29.02.2024, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr.57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet", të Ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullësor" i ndryshuar, në Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive" të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacionit përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", në VKM-në nr.592, datë 09.06.2018, për disa ndryshime në vendimin nr.1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor", në Udhëzimin e Ministrit Mjedisit nr.01, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik", neni 112 i ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të RSH, Këshilli Bashkiak :

V E N D O S I :

1. Në Vendimin nr.67, datë 29.09.2023 të Këshillit Bashkiak "Për dhënie e dakortësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullësor publik për ndërtim dhe operim të Hec "Grabova 1", nga shoqëria "Grabova Hydropower"shpk, pika 1 e tij të bëhet si më poshtë:

- Të shpreh dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor publik, për ndërtimin dhe operimin e Hec "Grabova 1" nga Shoqëria "GRABOVA HYDROPOWER"shpk të sipërfaqjes totale prej 0.2367 ha, në ngastrën pyjore nr.66 (0.1819 ha për veprat e marrjes+dekantues) të ekonomisë pyjore "Suhagorë-Mali i Grabovës", në nëngastrën pyjore nr.99/b (0.0122 ha për basenin e presionit) të ekonomisë pyjore "Dushku i Bulçarit" dhe në nëngastrën pyjore nr.97/a (0.0426 ha për ndërtimin e godinës së Hec "Grabova 1") të ekonomisë pyjore "Dushku i Bulçarit" në territorin administrativ të Bashkisë Gramsh.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.
 3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

ENIS ZANI

